VENDIM EKSTRAKT

Për kriterin e pranueshmërisë të parashikuar referuar nenit 120, pika 1, shkronja “c”

Ankuesi i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesë, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë së magjistratit me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, në kohën e kryerjes së shkeljeve të pretenduar disiplinore.

Në ankesë kundërshtohet vendimmarrja e gjyqtarit lidhur me rrëzimin e përsëritur të kërkesës për sigurimin e padisë, duke i konsideruar atë të njëanshme dhe jo profesionale. Gjithashtu, ka parashtruar pretendime lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së subjektit tregtar “X” sh.p.k., për të cilin pretendon se ushtron aktivitet pa leje mjedisore. Gjithashtu ankuesi ka depozituar në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, dokumentacion, shtesë në mbështetje te pretendimeve të ngritura prej tij.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në ushtrim të kompetencave të tij ligjore, shqyrton ankesat ndaj magjistratëve në përputhje me parashikimet e pjesës pjesës V, kreu II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe me dispozitat përkatëse të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Në nenin 120 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se ankesa për t'u pranuar për shqyrtim dhe për të vijuar me verifikimin dhe/ose hetimin disiplinor duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara shprehimisht nga pika l, shkronjat "a" deri "dh" të këtij neni. Konstatimi i mos përmbushjes së njërit ose më shumë prej këtyre kritereve passjell arkivimin e ankesës.

Nga shqyrtimi fillestar i ankesës referuar kritereve për pranueshmërinë e saj të parashikuara nga neni 120 i ligjit “Për statusin", rezulton se ankesa është paraqitur në formën e përcaktuar në nenin 120, pika 1, shkronja "a" të këtij ligji, pasi përmban gjeneralitetet e ankuesit dhe adresën e tij, përshkruan rrethanat e faktit që pretendohen të kenë ndodhur, si dhe përmban emrin dhe mbiemrin e magjistratit dhe prokurorinë pranë së cilës magjistrati ushtron funksionin. Për rrjedhojë, plotësohet kriteri i pranueshmërisë i parashikuar në nenin 120, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për sa i përket kriterit të pranueshmërisë lidhur me afatin e parashkrimit, parashikuar kjo në shkronjën “b”, pika 1, të nenit 120 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, plotësimi i këtij kriteri vlerësohet në raport me parashikimet e nenit 117 të këtij ligji, ku sipas këtij neni shkeljet disiplinore parashkruhen brenda 5 viteve. Nëse ILD merr të dhëna pas 5 viteve nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar ai nuk fillon hetimin disiplinor për shkak të parashkrimit. Në çdo rast afati i parashkrimit fillon nga momenti kur shkelja e pretenduar është kryer.

Nga shqyrtimi fillestar rezulton se të njëjtat pretendime, ndaj të njëjtit magjistrat, janë paraqitur më parë nga e njëjti ankues, nëpërmjet ankesave të bashkuara.

Këto pretendime i janë nënshtruar shqyrtimit fillestar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përfundim të të cilës është vendosur arkivimi i tyre nëpërmjet vendimit datë 12.05.2025. Nga përmbajtja e ankesës objekt shqyrtimi, nuk rezultojnë të jenë paraqitur fakte, ose rrethana të reja, që të përbëjnë objekt verifikimi nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Për rrjedhojë, ankesa nuk përmbush kriterin e pranueshmërisë të parashikuar nga neni 120, pika 1, shkronja "c", i ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, pasi përmban pretendime të përsëritura nga i njëjti ankues, të cilat i janë nënshtruar më parë shqyrtimit fillestar.

Në këto kushte, duke marrë në konsideratë përsëritjen e pretendimeve dhe mospërmbushjen e kriterit të pranueshmërisë, ankesa duhet të arkivohet në mbështetje të nenit 121, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 121 pika 2 shkronja "a", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe nenit 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar

VENDOSA

1. Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës të paraqitur ndaj veprimtarisë së magjistratit, me detyrë gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, në kohën e kryerjes së shkeljes disiplinore të pretenduar .
2. Në zbatim të nenit 121 pika 3 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimi t`i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij.
3. Kundër këtij vendimi, ankuesi, mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 (një) jave nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.